



Prishtinë, 18.12.2025
Kodi i ZRRE-së: V_3011_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2778_10_25** i datës 28.10.2025;
- Ankesa e konsumatorit e datës 05.12.2025.

në seancën e mbajtur më datë 18.12.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **F. S.**, nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. **ZRrE/DMK_V_2778_10_25** i datës 28.10.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 28.10.2025 ka marrë Vendim me nr. **ZRrE/DMK_V_2778_10_25** me të cilin e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e konsumatorit me shifër 005672, lidhur me kontestimin e faturimit me sipërfaqe ngrohëse/pa matje për sezonën ngrohëse 2024/25, dhe e ka obliguar NQ Termokos që për periudhën e kontestuar, konsumatorin ta korrigjoj dhe ta faturoj me matje, sipas gjendjeve të regjistruara në sistemin matës. Në pikën III të dispozitivit të Vendimit të kontestuar, është refuzuar si e pabazuar ankesa e konsumatores sa i përket kontestimit të komponentës së tarifave të konsumit të përbashkët.

E pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatorja **F. S.**, përfaqësuar sipas Autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve "Koci & Vokshi", gjegjësisht Av. Gerta Ragipi, brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Aplikimi praktik i tarifës së konsumit të përbashkët ka rezultuar në një ngarkesë disproporcionale për njësinë e saj banesore, duke sjellë një faturim të papërshtatshëm në raport me konsumimin real të energjisë termike.
- Tarifa e konsumit të përbashkët, nuk është e përfshirë në Vendimin e Bordit të ZRRE-së për përcaktimin e tarifave të energjisë termike i dt. 25.11.2024;



- Faturimi i konsumit të përbashkët nga NQ Termokos pa një bazë të qartë normative, është i pambështetur dhe i paargumentuar si dhe përben shkelje të parimeve të barazisë dhe proporcionalitetit në faturim, si dhe imponim të një detyrimi të paarsyeshëm financiar ndaj konsumatorëve.
- Konsumatorja kërkon aprovimin e ankesës, si dhe shfuqizimin e pikës III të dispozitivit të Vendimit të kontestuar, si dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në organin e shkallës së parë, vetëm sa i përket kësaj pjese të ankesës.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2025 i ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRrE-së për vlerësimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, lidhur me këtë ankesë, i ka shqyrtuar këto prova materiale: Ankesën e dt. 05.12.2025, Vendimin e DMK-së me nr. ZRrE/DMK_V_2778_10_25, Ankesën e konsumatorës me nr. 3086 e dt. 25.11.2024, Përgjigjen/njoftimin e NQ Termokos me nr. 3047 e dt. 13.12.2024; Faturat e muajve 10/2024, 11/2024 dhe 12/2024, Ankesën e konsumatores në DMK të ZRrE-së të dt. 24.01.2025, Kartelën e Konsumatorit, leximin dhe matjet për periudhën 10/2024-04/2025, si dhe dokumentet e tjera relevante si në shkresat e lëndës dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatores **është e pabazuar**, sepse:

Përgjatë analizimit të Vendimit të kontestuar si dhe provave të tjera si në shkresat e lëndës, vihet re, pasi që të dhënat për konsumin e energjisë termike tek konsumatorja kanë qenë të disponueshme dhe të sakta, DMK si shkallë e parë në ZRrE, e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e konsumatores dhe ka vendosur që, e njëjta duhet të korrigjohet për periudhën ngrohëse 2024/25, ashtu që, në vend të aplikimit të faturimit pa matje ose me sipërfaqe ngrohëse, të aplikohet faturimi me matje, sipas gjendjeve të regjistruara në sistemin matës. Më tej, janë paraqitur edhe të dhënat për konsumin e energjisë termike për çdo muaj, për gjithë sezonën ngrohëse. Gjithsesi, e refuzuar ka mbetur pjesa e ankesës sa i përket komponentës së tarifave të konsumit të përbashkët, për të cilin konsumatorja nuk pajtohet dhe kërkon korrigjimin e tërësishëm të faturimit, duke e hequr këtë komponent në faturimin e tërësishëm të energjisë termike.

Ndërlidhur me çështjen kryesore kontestuese, Bordi thekson se, konsumi i përbashkët, si komponent e tarifave të energjisë termike, është e përcaktuar me legjislacionin sekondar të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Në këtë kuptim, kjo komponent, i referohet energjisë termike e cila hyn në nënstacionin përkatës të një ndërtese kolektive dhe u shpërndahet në mënyrë proporcionale të gjithë konsumatorëve, ashtu që llogaritet dhe faturohet bazuar në pjesëmarrjen e sipërfaqes ngrohëse.

Pra, konsumi i përbashkët i energjisë termike si komponent fiks i tarifës përfaqëson sasinë e energjisë termike të shpërndarë dhe të shpenzuar për funksionimin e përgjithshëm të sistemit të ngrohjes qendrore të objektit, e cila nuk matet individualisht për çdo njësi, por shpërndahet ndërmjet të gjithë konsumatorëve të lidhur në sistem, pavarësisht nga konsumi i tyre individual.



Në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike me nr. 01/2022, gjegjësisht neni 16 – Struktura Tarifore dhe Faturimi, si në vijim: ***“Për konsumatorët me matje (siç është përcaktuar në paragrafin 5 të Nenit 15) tarifat duhet të jenë si në vijim: a) Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa (pagesa) mujore e kapacitetit bazuar në kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes [€/kWpër muaj]; b) Komponenti variabil i tarifës: ngarkesa mujore e energjisë bazuar në furnizimin e matur me ngrohje [€/MWh apo €/cent/kWh]; c) Nëse më shumë se një konsumator është i kyçur në një nënstacion (‘ndërtesat me shumë njësi’), atëherë konsumi i matur në këtë nënstacion do të shërbej si matje bazë për faturim, ndërsa alokimi tek konsumatorët bëhet si në vijim: c.1) në rastet kur në ‘ndërtesat me shumë njësi’ ekzistojnë pajisjet matëse në nivel njësie, alokimi bëhet sipas metodologjisë së përcaktuar në shtojcën ‘8’; dhe 16 c.2) në rastet kur në ‘ndërtesat me shumë njësi’ nuk ekzistojnë pajisjet matëse në nivel njësie, alokimi i konsumit të matur në nivel nënstacioni duhet të alokohet tek secili konsumator i kyçur proporcionalisht me sipërfaqen ngrohëse [m²]”, dhe duke iu referuar Shtojcës 8 – të Metodologjisë së Alokimit të Kostos së ngrohjes në ndërtesat me shumë njësi kolektive, tek Parimet Kryesore është përcaktuar si vijon: “Fatura e ngrohjes e konsumatorëve që banojnë në ndërtesat kolektive do të përbëhet nga: i) komponentët fiks: që merr parasysh kapacitetin termik të konsumatorit dhe konsumin e përbashkët të energjisë termike (ngrohjes) të ndërtesës, dhe do t’u tarifohen konsumatorëve pavarësisht nga sasia e ngrohjes së konsumuar; dhe ii) komponenti variabël që do të llogaritet në bazë të sasisë së matur të ngrohjes së konsumuar”, nuk qëndrojnë pretendimet e konsumatorës se, komponenta e konsumit të përbashkët, nuk është e normuar, nuk ka bazë ligjore dhe është e pambështetur, ngase sa mund të shihet, konsumi i përbashkët, si komponent fikse, është e përcaktuar me legjislacionin sekondar, dhe se, e njëjta u është shpërndarë në mënyrë proporcionale nga NQ Termokos dhe në harmoni me metodologjinë e alokimit të kostove.***

Tutje, pika d) e Bilancit të Konsumit të Energjisë Termike (ngrohjes) së një ndërtese me shumë njësi (kolektive), parashihet si në vijim: ***“Në ndërtesën me shumë njësi, krahas konsumit të ngrohjes së njësisë, është prezent edhe ‘konsumimi i përbashkët’, në formën e: i) transmetimit të nxehtësisë nga tubat që kalojnë nëpër hapësirat e përbashkëta të ndërtesave (korridoret, shkallët etj.); ii) transmetimi i nxehtësisë nga tubat që kalojnë nëpër njësi (në rastin e përdorimit të HCA-ve të montuar në radiatorë); dhe iii) transmetimin e nxehtësisë ndërmjet mureve dhe tavaneve të njësisë ngjitur”.***

Më tej, edhe në Vendimin për tarifën e energjisë termike për konsumatorët fundorë të NQ Termokos SH.A., për sezonën ngrohëse 2024/2025 dhe në tabelën në të cilën paraqitet struktura e tarifave të energjisë termike, përfshihen dy komponentët – komponenta fikse dhe komponent variabile. Dhe në këtë kuptim, pjesa tjetër e legjislacionit, gjegjësisht në Metodologjinë e Alokimit të Kostove të Ngrohjes në ndërtesat me shumë njësi përcaktohet konkretisht se çka përfshinë komponenta fikse e tarifave, si kapaciteti termik dhe konsumi i përbashkët.

Përfundimisht, pretendimet e konsumatores se aplikimi praktik i tarifës së konsumit të përbashkët ka rezultuar në një ngarkesë disproporcionale dhe pa bazë normative, janë të pabazuara dhe të pambështetura juridikisht, për faktin se kjo komponent, përbën pjesë integrale të strukturës tarifore të shërbimit të ngrohjes qendrore dhe lidhet me funksionimin e përgjithshëm të sistemit, e jo me konsumin individual të matshëm. Andaj, nga sa u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Adnan Preniqi, Anëtar